Ministri i Kulturës, Asaf Ademi, mbrëmë në Kinotekën e Maqedonisë së bashku me Këshilltaren e vjetër në Ambasadën e Mbretërisë Daneze në Beograd – kompetente edhe për Republikën e Maqedonisë, Mariane Gade Topaç dhe Konsullin e Nderit të Mbretërisë Daneze në vendin tonë, Zhivko Muaketov mori pjesë dhe mbajti fjalë rasti në solemnitetin e organizuar me rastin e manifestimit “Java e filmit bashkëkohor danez”, në kuadër të të cilit do të prezantohet përzgjedhja e kinematografisë daneze...



Ademi, i cili një pjesë të angazhimit profesional e ka kaluar si ambasador i Republikës së Maqedonisë në Mbretërinë Daneze, në fjalën e tij theksoi se marrëdhëniet e Republikës së Maqedonisë më shtetet evropiane, duke përfshirë edhe Mbretërinë Daneze zhvillohen në

frymën e miqësisë dhe mirëkuptimit të ndërsjellë.



Prandaj është e rëndësishme të njihet një pjesë e kulturës daneze, e cila është unikate, dhe të shihet kontributi i krijimtarisë filmike daneze që ia ka dhuruar kinematografisë botërore, “Në ditët në vijim do të kemi ditë emocionuese filmike me përzgjedhjen e gjashtë filmave me metrazh të gjatë të cilët, besoj se, do t’i kënaqin shijet e artdashësve të filmit këtu në Maqedoni.



